

Presidenti Meta pret personalitetet arbëreshë: Tradita e tyre vlerë botërore



Postuar: 13/11/2017 - 17:00

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti sot personalitetet e shquara arbëreshe, Imzot Giorgio Demetri-Gallaro, Arqipeshkv i "Piana degli Albanesi", Profesor Mateo Mandala-Universiteti Palermos dhe Profesor Francesko Altimari-Universiteti i Cozencas.

Presidenti Meta vlerësoi kontributin e jashtëzakonshëm të profesorëve të nderuar arbëreshë në fushën e studimit të gjuhës shqipe dhe të shkencave të Albanologjisë dhe rolin frymëzues shpirtëror në "Piagna degli Albanesi" të Arqipeshkvit Imzot Gallaro.

"Elita intelektuale e arbëreshëve të Italisë, me përkushtimin dhe dashurinë ndaj mëmëdheut të tyre, kanë rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e gjuhës, traditave, dokeve e riteve të të parëve, si dhe përcjelljen e tyre te brezat e rinj", nënvizoi Presidenti Meta gjatë takimit.

Presidenti Meta theksoi rëndësinë që ka jo vetëm për arbëreshët dhe shqiptarët, por edhe për Italinë si dhe për kulturën botërore, trashëgimia e komunitetit arbëresh, historia, traditat e tyre si një vlerë jomateriale e kulturës botërore në kuadër të UNESCO-s.

Presidenti Meta vuri në dukje rëndësinë e bashkëpunimit me komunitetin arbëresh, intelektualët dhe shoqatat e tyre në Itali për të organizuar aktivitete të përbashkëta në kuadër të vitit të Skënderbeut, të kësaj figure përbashkuese dhe emblematike për kombin tonë.

/Agjencia e Lajmeve Sot News/